



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
DREJTORIA E AUDITIMIT TE BRENDSDHEM

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

Për

vlerësimin e sistemeve në Qendrën Ndërinstitucionale Operacionale Detare (Rep.6012)

Durrës

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare (Rep. 6012), Durrës, këtu e në vazhdim “QNOD”, është strukturë ndërdikasteriale në varësi të Ministrit të Mbrojtjes, dhe ka për detyrë të sigurojë vëzhgimin e hapësirës detare shqiptare, për të realizuar organizimin, planëzimin, bashkërendimin dhe drejtimin e operacioneve në det, në përputhje me legjislacionin detar kombëtar dhe ndërkombëtar.

Veprimtaria e QNOD-së, është mbështetur në një bazë të gjerë legjislacioni (*ligje, VKM, udhëzime, etj.*), urdhrat dhe udhëzimet e Ministrit të Mbrojtjes, Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së dhe Titullarit të QNOD-së, në fushën e veprimtarisë së saj, operacionale, të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe aktiveve (*financiare dhe materiale*).

Objektivi kryesor, i angazhimit të auditimit, në Qendrën Ndërinstitucionale Operacionale Detare (Rep. 6012), Durrës, është auditimi i veprimtarisë dhe vlerësimi i funksionimit të sistemeve (*sistemi i kontrollit të brendshëm, sistemi i kryerjes pagesave nga arka dhe banka dhe sistemi i menaxhimit të aktiveve financiare dhe materiale*), përputhshmëria dhe respektimi i kërkesave të legjislacionit, që rregullon fushën e veprimtarisë së kësaj njësie. Identifikimi i risqeve dhe mangësive, si dhe dhënia e rekomandimeve për veprime korrigjuese.

Objekti i këtij auditimi, është vlerësimi i përputhshmërisë së veprimtarisë me legjislacionin dhe rregullat e miratuara, sipas fushës dhe rregullshmëria e dokumentacionit për veprimet financiare të kryera nga Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare (Rep. 6012) Durrës, për periudhën objekt auditimi, duke vlerësuar nëse;

- janë respektuar dhe zbatuar drejt kërkesat e legjislacionit (*aktet ligjore dhe nënligjore*) në fuqi, urdhrat e udhëzimet e Ministrit të Mbrojtjes dhe Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, mbi bazën e të cilave funksionon dhe kryen veprimtarinë QNOD-ja;
- burimet njerëzore, financiare dhe materiale, të miratuara dhe dhënë në përdorim në interes të plotësimit të misionit dhe kryerjes së detyrave, janë përdorur në përputhje me kërkesat e legjislacionit dhe me efikasitet dhe efektivitet.

Qëllimi i angazhimit të auditimit;

- Vlerësimi i veprimtarisë drejtuese e menaxheriale, nëse sistemi i kontrollit të brendshëm ka funksionuar, menaxhimi i aktiveve financiare, menaxhimi dhe administrimi i aktiveve materiale dhe dokumentimi i veprimeve të kryera, janë në përputhje me legjislacionin rregullator, ku bazohet dhe ushtron veprimtarinë e saj, QNOD-ja.
 - Vlerësimi i fushave me risk, ku përfshihet, rregullshmëria e dokumentacionit në sistemin e pagesave, në sistemin e kontabilitetit, fushat e menaxhimit dhe administrimit të aktiveve (*financiare dhe materiale*), identifikimi i mangësive dhe pasaktësive, nëpërmjet të cilave synojmë, dhënien e titullarët, për periudhën objekt auditimi, të një informacioni korrekt, për veprimtarinë QNOD-ja dhe një vlerësim të drejtë, objektiv dhe të pavarur të aktivitetit të saj.
- Kjo në interes të plotësimit të misionit dhe dhënies së rekomandimeve për përmirësimin e punës në të ardhmen, bazuar në gjetjet dhe konkluzionet e nxjerra nga evidencat e mbledhura.
- Përgatitja e raporteve të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve nga auditimi, dhënia e opinioneve dhe rekomandimeve për përmirësime, mbështetur në evidencat përkatëse të besueshme dhe të mjaftueshme.

Periudha kohore. Angazhimi i auditimit përfshin veprimtarinë e Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare (*Rep. 6012*), Durrës, për veprimtarinë e periudhës 01.01.2019 deri më 31.12.2023.

1. HYRJE

Bazuar në ligjin nr.114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” ndryshuar, Manualin e Auditimit të Brendshëm, miratuar nga Ministri Financave me urdhërin nr.100 datë 25.10.2016, programin vjetor të auditimeve, për vitin 2024, miratuar nga Ministri i Mbrojtjes me nr.2247, datë 17.10.2023 dhe në zbatim të programit të auditimit nr.1370, datë 22.05.2024, “Vlerësimin e sistemeve në Qendrën Ndërinstitucionale Operacionale Detare (Reparti 6012), Durrës”, miratuar nga Drejtori i Auditimit.

Angazhimi i auditimit, u krye nga data 03.06.2024 deri 28.06.2024.

Angazhimi i auditimit në Qendrën Ndërinstitucionale Operacionale Detare, (*Rep.6012*), Durrës, i kushtoi vëmendje të veçantë çështjeve që lidhen me zbatimin e legjislacionit (*aktet ligjore e nënligjore*) për;

- zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme.
- sistemin e kontrollit të brendshëm,

- sistemin e funksionimit administrativ,
- sistemin e planifikimit dhe buxhetimit,
- sistemin e menaxhimit të burimeve njerëzore,
- sistemin e pagave dhe shpërblimeve,
- sistemin e raportimit financiar dhe kontabilitetit,
- sistemin e prokurimit,
- sistemin e menaxhimit të aktiveve të qendrueshme,
- sistemin e kryerjes së pagesave me bankë

Për periudhën objekt auditimi, vlerësimi i veprimtarisë së QNOD-së, është bazuar në legjislacionin në fuqi, i cili ka lidhje me fushat e veprimtarisë që auditohen, sipas pikave të programit të auditimit.

Auditimi u krye, nga grupi i auditimit i përbërë nga znj. Irida **Bushati**, përgjegjës grupi dhe znj. Arsela **Marku**, audituese.

2. METODA E AUDITIMIT

Angazhimi i auditimit bazohet kryesisht në auditimin në bazë sistemi, nëpërmjet auditimit të përpuethshmërisë së veprimeve me legjislacionin, auditimit financiar për vlerësimin e saktësisë, plotësisë dhe ligjshmërisë së veprimeve financiare, duke përdorur si metoda auditimi: ekzaminim kryq, inspektim fizik, intervistimin, rishikim analitik, krahasim, kryesisht për vlerësimin e saktësisë dhe besueshmërisë së dokumentacionit që auditohet, etj.

Konkluzion i përgjithshëm

Nga auditimi i realizuar vlerësohet se, nga ana e QNOD-së, janë ngritur dhe funksionojnë sistemet e kontrollit të brendshëm, të cilat janë shoqëruar me nxjerrjen e urdhrave dhe udhëzimeve për detajimin, ndjekjen dhe zbatimin e buxhetit, kryerjen e pagesave, zbatimin e procedurave të prokurimit (*blerje me vlerë të vogël*), administrimin e aktiveve materiale (*për pritjen dhe marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve*), organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit dhe përgatitjen e pasqyrave financiare.

Nga auditimi vlerësohet se, menaxhimi i fondeve dhe i aktiveve materiale në përdorim të QNOD-së, për plotësimin e detyrave dhe misionit të saj, duhet të ishin bërë më efektiv, kjo nëpërmjet njohjes dhe zbatimit të legjislacionit përkatës, kryerjes së kontrolleve të brendshme parandaluese.

Grupi i auditimit jep konkluzionin si vijon:

- Në vlerësimin e administrimit të aktiveve, që lidhet me shkarkimin e konsumit të karburantit sipas normave të miratuara, kërkohet përmirësim i mënyrës së rakordimeve mujore dhe atij vjetor të financës dhe magazinës.
- Regjistri i realizimeve të procedurës së prokurimit publik kërkohet të plotësohet sipas formatit standard 2, i përcaktuar në udhëzimin e APP-së nr 4 datë 18.06.2021 “*Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik*”.

GJETJE, KONKLuzionet dhe Rekomandimet për Çdo Sistem.

I. Auditimi i mjedisit të kontrollit të brendshëm.

I.1. Auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve dhe detyrave të lëna nga auditimi i mëparshëm

Auditimi i fundit në QNOD është realizuar në vitin 2019 dhe përfshin periudhën 2016 - 2018. Në raportin përfundimtar të auditimit, konstatohet se, janë lënë detyra të karakterit organizativ. Nga ana e kësaj njësie është dërguar informacion me shkresë nr 484/1 prot. datë 13.12.2019, mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi, referuar plan veprimit me nr 167/1 datë 24.4.2019 të miratuar nga Titullari i QNOD.

Në raportin përfundimtar të auditimit me shkresë nr 2126/3 datë 12.04.2019, nga grupi i auditimit janë dhënë gjithsej 7 (shtatë) rekomandime, nga të cilat janë realizuar plotësisht 6 (gjashtë) rekomandime, ndërkohë që për një rekomandim, në lidhje me inventarizimin e ndërtesës në përdorim, QNOD ka ndjekur në rrugë zyrtare komunikimin me Komandën e Forcës Detare të cilës i përket kjo pronë, përkatësisht si më poshtë:

Me shkresë nr.166 datë 24.04.2019, QNOD-ja i është drejtuar Komandës së Forcave Detare për plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor për kompletimin e dosjes teknike të godinës 3 -katëshe tashmë në përdorim të QNOD-së.

Me shkresë nr 1493/1 të datës 07.05.2019 nga ana e Komandës së Forcave Detare është kthyer një përgjigje QNOD-së, duke sqaruar që me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes nr. 781 datë 05.05.2010 “Për kalim kapital të objektit godinë 3-katëshe, ish komanda FD”, ju është dorëzuar objekti me të gjitha materialet dhe pajisjet në funksion të saj, shoqëruar me kartelat përkatëse dhe planimetritë për secilin kat, pa sipërfaqe truall n/objekt apo truall funksional.

Nga ana e grupit të auditimit, edhe ky rekomandim quhet i realizuar nga QNOD, pasi ka shteruar mundësitë e saj për veprime.

I.2. Auditimi i funksionimit organizativ

QNOD-ja (Rep 6012), Durrës, për periudhën 01.01.2019 deri 31.12.2023, si strukturë organizative ka funksionuar sipas urdhërit të Kryeministrit nr. 119 datë 31.07.2018, “Për miratimin e Strukturës dhe të organikës së Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare” dhe VKM nr 585 datë 01.07.2015 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr 439 datë 13.05.2011 “Për miratimin e dokumentit”, politikat dhe procedurat e funksionimit të Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare”.

Ky institucion ka në përbërje strukturore personel nga institucionet që kanë kompetenca dhe kryejnë detyra në hapësirën detare, sipas nenit 32 të ligjit 9251 datë 08.07.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, siç janë:

- Ministria e Mbrojtjes (me prani 24 orësh të Rojes Bregdetare)
- Ministria e Brendshme (me prani 24 orësh të Policisë Kufitare dhe Emigracionit)
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (me prani 24 orësh të Drejtorisë së Përgjithshme Detare/Kapitenerisë)

- Ministria e Financave (me prani 24 orësh të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave/ Anti kontrabandës Detare)
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (prani 24 orësh të Drejtorisë së Peshkimit dhe Akuakulturës)
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (kapacitet bashkërendues sipas nevojës)

Ndërkohë vetë QNOD, aktualisht ka strukturë të përbërë prej 24 punonjës si më poshtë:

- Drejtori Administrativ (në vazhdim Titullari)
- Drejtori i Planifikimit dhe Shërbimeve Mbështetëse
- Koordinatorët e Institucional (të ministrive të linjës)
- Administratorët e Sallës Operacionale
- Oficerët e shërbimit/oficerë civil të turnit (nga disa agjensi ligjzbatuese)
- Operatorët e sistemit dhe operatorët e komunikimit
- Personeli i Njësisë TIK të AKSHI- t
- Personeli i sektorëve mbështetës

Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare, (Rep.6012) Durrës, për periudhën objekt auditimi, ka funksionuar, si njësi shpenzuese, duke përballuar nevojat për aktive financiare dhe materiale, për gjithë personelin e Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare.

Veprimtaria e QNOD-së në drejtim të aktivitetit ekonomik e financiar, për këtë periudhë ka funksionuar bazuar në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 *“Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH”* ndryshuar, ligjin nr.10 296 datë 08.07.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”* i ndryshuar, legjislacionit për pagat, udhëzimit të MF-së nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”* ndryshuar, udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.3.2018 *“Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”* i ndryshur, udhëzimet e MF *“Për përgatitjen e PBA-së”* i ndryshuar, ligjeve respektive vjetore për miratimin e buxhetit, urdhrave dhe udhëzimeve të Ministrit të Mbrojtjes, shkresave të Sekretarit të Përgjithshëm të MM-së, etj.

I.3. Vlerësimi i mjedisit të kontrollit, planifikimi dhe menaxhimi i riskut.

I.3.1. Mjedisi i kontrollit të brendshëm

Në zbatim të ligjit 10296/2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”* i ndryshuar, udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”* ndryshuar, nga auditimi i realizuar, vlerësohet se në tërësi janë ngritur dhe funksionojnë sistemet e kontrollit të brendshëm, të shoqëruara këto me nxjerrjen e urdhrave për ngritjen e grupeve të punës për pritjen dhe marrjen në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve; urdhrave dhe udhëzimeve për detajimin, ndjekjen dhe zbatimin e buxhetit; zbatimin e procedurave të prokurimit blerje me vlerë të vogël; organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit, përgatitjen e pasqyrave financiare; administrimin e aktiveve; rregullave për kryerjen e pagesave për pagat dhe shtesat mbi pagë, etj.

Nga titullari i QNOD-së janë marrë masa dhe nga strukturat përkatëse ka patur një monitorim të vazhdueshëm të zbatimit të akteve të nxjerra për zbatimin e standardeve në fushën e menaxhimit financiar e të kontrollit, të menaxhimit të riskut, të burimeve njerëzore, në përmirësimin e burimeve financiare dhe materiale, duke ndikuar në përmbushjen e objektivave dhe detyrave të funksionimit të kësaj njësie për periudhën objekt auditimi.

Për vlerësimin e funksionimit në tërësi të sistemit të kontrollit të brendshëm, grupit të auditimit i është vënë në dispozicion për çdo vit, dokumentacioni lidhur me:

- Rregulloret e funksionimit të QNOD-së e miratuar me VKM nr 439 datë 13.05.2011 e ndryshuar;
- Struktura organizative e miratuar me VKM, si dhe ndarja e detyrave është e përcaktuar në rregulloren e njësisë.
- Analiza vjetore
- Pyetësorët e vetëvlerësimit të komponentëve të menaxhimit financiar dhe të kontrollit,
- Deklaratën për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm
- Raportin për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

I.3.2. Planifikimi dhe menaxhimi i riskut

QNOD-ja ka hartuar regjistër risku për vitin 2021 dhe në vazhdim, në zbatim të urdhërit të Ministrit të Financave nr. 16 të datës 20.07.2016 *“Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”*. Regjistri i riskut, së bashku me raportin mbi analizën e risqeve për çdo vit, është dërguar në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në MM.

Në regjistrin e riskut janë të përcaktuara objektivat dhe qëllimet që lidhen me realizimin e detyrave të njësisë.

I.4. Kontrolli i aktiviteteve (veprimtarive) dhe monitorimi i tyre

Gjatë angazhimit të auditimit, për vlerësimin e funksionimit të veprimtarive të kontrollit të brendshëm në QNOD, auditimi u përqendrua në vlerësimin e rregullave të vendosura për zhvillimin e aktivitetit të përditshëm për zbatimin e objektivave, ku rezultoi se, titullari, për çdo rast, ka nxjerrë akte të brendshme dhe urdhra për zbatim të detyrave, për pagesat e ndryshme, pritjen dhe kontrollin e materialeve apo shërbimet e blera, kryerjen e inventarizimeve, shkarkimet dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve, etj., të cilat konstatohet se janë respektuar, por për çështje të caktuara, ka nevojë për përmirësime, të cilat trajtohen në vijim të këtij raporti.

I.4.1. Informimi dhe komunikimi

Nga auditimi dokumentacionit konstatohet se, strukturat e QNOD-së, titullari dhe punonjësit janë të informuar vazhdimisht nga strukturat përkatëse të Ministrisë, mbi urdhëra, komunikime zyrtare, informacione të domosdoshme mbi veprimtarinë e kësaj njësie.

I.4.2. Monitorimi

Monitorimi është procesi i rishikimit të veprimtarive të njësisë, që kanë për qëllim të ofrojnë siguri të arsyeshme të veprimtarive të kontrollit të cilat funksionojnë sipas qëllimit për të cilin janë ngritur. Punonjësit nën mbikëqyrjen e drejtuesit, raportojnë realizimin e objektivave periodikisht në përgjegjësinë e tyre, duke i dërguar dhe në Ministri me shkresa përcjellëse.

Konkluzion mbi mjedisin e kontrollit të brendshëm

Për sa më lart rezulton se, menaxhimi financiar dhe sistemi i kontrollit brendshëm në këtë njësi ka funksionuar dhe është kryer në funksion të legjislacionit për menaxhimin financiar dhe kontrollin. Rastet e mangësive dhe të shkeljes së procedurave do të shqyrtohen si gjetje më vehte sipas çështjeve të shqyrtuara në vazhdim.

II. AUDITIMI I PËRPUETHSHMËRISË

II.1. Programimi i nevojave dhe përgatitja e planifikimit buxhetor

Përgatitja e programit buxhetor afatmesëm (PBA-së), për vitet 2019-2021, 2020-2022, 2021-2023, 2022-2024, 2023-2025, është mbështetur në misionin, programet, veprimtaritë, politikat, objektivat dhe prioritetet e QNOD-së, duke mbajtur parasysh edhe tavanet buxhetore të miratuara në nivel artikulli të klasifikimit buxhetor.

Në përgatitjen e projekteve janë respektuar kërkesat e udhëzimeve të dërguara për këtë qëllim. Menaxhimi i buxhetit për periudhën 2019-2023, është mbështetur në Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH” me ndryshime, ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, udhëzimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit të shtetit”, si dhe çdo akt tjetër ligjor e nënligjor që lidhen me zbatimin e buxhetit për të gjithë periudhën objekt auditimi.

Për vitet 2019- 2023, QNOD-ja ka kryer raportime mujore në Drejtorinë e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar në MM.

II.2. Auditimi për miratimin, ndryshimet e bëra gjatë vitit dhe zbatimi i buxhetit

Programimi i nevojave për shpenzimet e personelit për artikullin 600 “Paga” është bazuar në numrin e punonjësve limit të miratuar sipas kategorive përkatëse (*ushtarakë dhe civil*) duke llogaritur pagën për gradë/funksion sipas tabelave të pagave dhe shtesat e tjera mbi pagë (*vjetërsi, vështirësi, dëmshmëri ...*), ndërsa për artikullin “601” shpenzimet e kontributeve për sigurime shoqërore dhe shëndetësore janë llogaritur sipas tarifave përkatëse përcaktuar në aktet ligjore në fuqi.

Nevojat buxhetore, për mallra e shërbime në artikullin “602”, janë përlllogaritur duke u bazuar në nevojat për bazë materiale, punime e shërbime dhe normat e përcaktuara në rregulloret e shërbimeve përkatëse, ndërsa për shpenzimet me të tretët, kryesisht nga eksperiencia e realizimeve të mëparshme. Gjatë auditimit në lidhje me zbatimin dhe realizimin e buxhetit, audituesi u përqëndrua fillimisht në dokumentimin e kësaj fushe, nëpërmjet verifikimit të praktikës dokumentare të plotësuar për këtë

qëllim, që nga detajimi i fondeve në fillim të vitit, ndryshimet e bëra, (*shtesa dhe pakësim të fondeve*), gjatë vitit, rakordimi dhe pasqyrimi i tyre në pasqyrat e situacioneve të zbatimit të buxhetit vjetor të plotësuar nga nëpunësit zbatues dhe konfirmuar nga nëpunësit e degës së thesarit Durrës.

Raportimi i evidencave për zbatimin e buxhetit vjetor, është bërë sipas afateve të përcaktuara në strukturat eprorë të MM-së.

Detajimi i buxhetit, i është dërguar QNOD-së çdo vit, në nivel artikulli e n/artikulli dhe në total. Buxheti i miratuar me ndryshimet dhe shpenzimet faktike të realizuara sipas viteve paraqiten si më poshtë:

Nr	Vitet	Buxheti i miratuar me ndryshime (vlera në lekë)	Shpenzime Faktike (në lekë)	Diferenca (në lekë)	Realizimi (në %)
1	2019	28,799,425	24,890,664	3,908,761	86%
2	2020	26,182,750	24,438,768	1,743,982	93%
3	2021	26,792,466	26,265,811	526,655	98%
4	2022	26,471,300	26,448,953	22,347	100%
5	2023	38,580,400	30,826,584	7,753,816	80%

Auditimi në këtë fushë, u përqëndrua kryesisht në drejtim të respektimit të disiplinës financiare për fondet e miratuara sipas klasifikimit buxhetor dhe vlerëson se: ndryshimet e fondeve të bëra nga viti 2019 e në vijim janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe kompetencat e përcaktuara për nëpunësit autorizues sipas nivelit dhe autoritetit përkatës.

Situacionet e zbatimit të buxhetit janë të nënshkruara rregullisht nga personat përgjegjës dhe nga nëpunësi i degës së thesarit Tiranë.

Raportimi i evidencave për zbatimin e buxhetit është bërë sipas afateve të përcaktuara dhe linjës së raportimit në strukturat eprorë.

Opinionimi i grupit të auditimit: Sa më sipër, referuar ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH*”, i ndryshuar, udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 22, datë 17.11.2016 “*Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore*”, si dhe udhëzimi i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.9, datë 20.3.2018 “*Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit*”, duke analizuar treguesit e buxhetit vjetor (ndryshimet) të miratuar dhe duke i krahasuar ato me realizimin e shpenzimeve faktike, në nivel artikulli dhe buxheti vjetor, konstatohet se, treguesit buxhetorë për vitet 2019, 2020, 2023, janë me mos realizim. Për vitin 2023 për llog 231, sipas shpjegimeve të bëra në shkresën nr 511 datë 15.08.2024, “*Dërgim i materialeve me kundërshtimet dhe sugjerimet përkatëse në lidhje me projektraportin e auditimit të brendshëm*”, ka mosrealizim për shkak se nuk është kryer prokurimi për llogarinë e investimeve, “*kondicioner zyresh*” në vlerën 1,400,000 lekë.

II.3. Auditimi për respektimin e kërkesave të legjislacionit për pagat.

II.3.1. Burimet njerëzore, respektimi i strukturës, organikës dhe limeteve të miratuara

Auditimi i sistemit të pagesave për personelin e QNOD-së, për paga, shtesat mbi pagë dhe shpenzime të tjera personeli, u krye për periudhën 01.02.2019 deri 31.12.2023.

Struktura organizative e QNOD-së është e miratuar për 24 punonjës (*ushtarak dhe civil*) sipas urdhërit të Kryeministrit, nr.119 datë 31.07.2018, “Për disa ndryshime në urdhërin nr.116, datë 18.07.2016 të Kryeministrit për miratimin e strukturës dhe të organikës së Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare”. Në fakt, personeli i paguar për periudhën 01.02.2019 - 31.12.2023 ka qënë mesatarisht 22 punonjës.

Lidhja	PERIUDHA E AUDITIMIT														
	2019			2020			2021			2022			2023		
	N/Oficer	Civil	Total	N/Oficer	Civil	Total	N/Oficer	Civil	Total	N/Oficer	Civil	Total	N/Oficer	Civil	Total
Limit	5	19	24	5	19	24	5	19	24	5	19	24	5	19	24
Fakt	5	18	23	5	16	21	4	19	23	3	19	22	3	19	22

Për sa më sipër, rezulton se janë respektuar limitet e personelit dhe të fondeve të dhëna në përdorim për pagesën e këtij personeli për paga dhe shpenzime të tjera personeli dhe nuk u konstatuan pagesa mbi limitet e miratuara.

II.3.2. Rregullshmëria e përgatitjes së listëpagesave dhe përlllogaritja e pagave

Për vlerësimin e sistemit të kryerjes së pagesave për pagat, përfitimet e shtesave mbi pagë dhe rregullshmërinë e përgatitjes së listëpagesave, grupi i auditimit, auditori listëpagesat dhe dokumentacionin justifikues bashkëlidhur tyre, për respektimin e strukturës, fondit të pagave dhe legjislacionit në fushën e pagave, për gjithë periudhën objekt auditimi, kryesisht nëse **listëpagesat**:

- Për personelin ushtarak, janë përgatitur sipas strukturës, pagës për gradë dhe viteve të shërbimit në FA .
- Për punonjësit civil me arsim të lartë, janë përgatitur sipas strukturës, pagës për shtesë pozicioni për kategori, pagës grupit dhe shtesë vjetore për vjetërsi në përqindje mbi pagën e grupit, si dhe për punonjësit mbështetës (civil) pagës për klasë, vjetërsi dhe dëmshmëri.
- Për përfitimet (shtesat) mbi pagë, për ushtarakët, janë kryer sipas VKM-së nr.224, datë 21.03.2017, “Për trajtimin me paga dhe shtesa mbi pagë të ushtarakëve aktiv të FARSH” i ndryshuar.
- Për pagat dhe shtesat mbi pagë (shtesë për vjetërsi) për punonjësit me arsim të lartë, për periudhën Shkurt 2019 - 1 Prill 2023, janë kryer sipas VKM nr.187, datë 08.03.2017 “Për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësvenë aparatet e Ministrive të Linjës institucionet në varëse të Ministrive të Linjës.....”, i ndryshuar.

Ndërsa për periudhën 1 Prill 2023 e në vazhdim, janë kryer sipas VKM nr.325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të nëpunësve civil dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, i ndryshuar.

Pagat dhe shtesat mbi pagë (shtesë për vjetërsi, dëmshmëri) për punonjësit mbështetës, për periudhën Shkurt 2019 deri në Prill 2022, janë kryer sipas VKM-së nr. 717 datë 23.06.2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore”, për periudhën Prill 2022 – Prill 2023 sipas VKM nr.234, datë 20.04.2022 “*Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike*”, i ndryshuar.

Ndërsa për periudhën 1 Prill 2023 e në vazhdim, pagesat janë kryer sipas VKM-së nr.326, datë 31.05.2023 “*Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike*”, i ndryshuar.

Kryerja e ndalesave, tatimi mbi të ardhurat, kontributi për sigurimin shoqëror e shëndetësor dhe ai suplementar për ushtarakët, janë bërë sipas kriterëve dhe masës së përcaktuar në legjislacionin përkatës.

Bashkëlidhur listëpagesave, gjendet dokumentacioni tjetër justifikues, si kohëshënuesi, urdhra të titullarit, raporte mjekësore etj., të nënshkruara nga specialisti i personelit dhe specialisti i financës së QNOD-së (Rep.6012), etj.

Nga auditimi i listëpagesave, për përputhmërinë me kërkesat e legjislacionit të mësipërm, rezultoi sa më poshtë:

- Listëpagesat, për të gjithë periudhën e audituar janë përgatitur dhe janë nënshkruar nga specialisti i financës, përgjegjësi i sektorit të financës dhe nga titullari.
- Në përgatitjen e listëpagesave, janë respektuar kërkesat e udhëzimit të Ministrit të Financave nr.30, datë 27.12.2011, “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar dhe udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike nr.4, datë 13.12.2016 “*Për formën, elementët dhe plotësimin e bordorosë së pagave për njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”.
- Listëpagesat janë përgatitur në përputhje me strukturën (limitin e punonjësve për efekt buxheti), me pagën për gradë dhe vjetërsisë së shërbimit në FA për personelin ushtarak, me pagën për kategori (pozicion pune) për punonjësit civil me arsim të lartë dhe pagës për klasë për punonjësit mbështetës (civil).

II.3.3. Respektimi i kërkesave të legjislacionit për trajtimin dhe përlogaritja e pagës të personelit ushtarak

Trajtimi me pagë dhe shtesa mbi pagë i personelit ushtarak të QNOD-së (Rep.6012) Durrës, për periudhën e audituar, është kryer sipas kërkesave të VKM-së nr.224, datë 21.03.2017 “*Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të ushtarakëve aktiv të Forcave të Armatosura të RSH*”, ndryshuar, lidhjes nr.1, të këtij vendimi, si dhe sipas VKM-së nr.426, datë 22.06.2022 “Për disa ndryshime në vendimin nr.224, datë 21.03.2017, të Këshillit të Ministrave, “*Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të ushtarakëve aktivë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë*”, të ndryshuar.

Përveç trajtimit me pagë, sipas gradës dhe vjetërsisë në shërbim, personeli ushtarak i QNOD-së, është trajtuar edhe me shtesë mbi pagë për punë të vështirë e të dëmshme në shëndet, sipas lidhjes nr.6 të VKM-së nr.224, datë 21.03.2017, i ndryshuar.

Nga auditimi i përpunueshmërisë me kërkesat e legjislacionit në fushën e pagave, saktësisë, plotësisë dhe ligjshmërisë së veprimeve financiare për kryerjen e pagesave, për personelin ushtarak të QNOD-së, nuk u konstatuan shkelje dhe mangësi.

II.3.4. Respektimi i kërkesave të legjislacionit dhe përlogaritja e pagës të punonjësve civil me arsim të lartë

Trajtimi me pagë i punonjësve civil me arsim të lartë në QNOD (Rep.6012), Durrës, për periudhën Shkurt 2019 - Prill 2023, është bërë sipas VKM-së nr.187, datë 08.03.2017, *“Për miratimin e strukturës dhe nivelit të pagave të nëpunësve civil/nëpunësve.....në varësi të KM, institucioneve në varësi të Ministrive të linjës.....”*, i ndryshuar dhe për periudhën 1 Prill 2023 e në vazhdim është bërë sipas VKM-së nr.325, datë 31.05.2023 *“Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe të shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civil dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”*, i ndryshuar, për periudhën objekt auditimi janë trajtuar 14 punonjës.

Nga auditimi për rregullshmërinë dhe saktësinë në kryerjen e pagesave, nuk u konstatuan shkelje dhe mangësi.

II.3.5. Respektimi i kërkesave të legjislacionit për përlogaritjen e pagës të punonjësve civil mbështetës

Trajtimi me pagë i punonjësve të tjerë civil (punonjës mbështetës) në QNOD (Rep.6012), për periudhën Shkurt 2019 deri në Prill 2022, është kryer sipas VKM-së nr.717 datë 23.06.2009 *“Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore”* i ndryshuar, për periudhën Prill 2022 – Prill 2023, sipas VKM-së nr. 234, datë 20.04.2022 *“Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”*, i ndryshuar dhe për periudhën 1 Prill 2023 e në vazhdim, janë kryer sipas VKM-së nr. 326, datë 31.5.2023 *“Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”*, i ndryshuar, ku rezulton se, për periudhën objekt auditimi, janë paguar mesatarisht 3-5 punonjës në muaj dhe konstatohet se janë respektuar kërkesat e legjislacionit për pagesat e kryera për pagën mujore dhe shtesat mbi pagë.

II.3.6. Rregullshmëria e përlogaritjes dhe derdhjes së kontributeve për sigurime shoqërore

Nga auditimi i listëpagesave për rregullshmërinë e përlogaritjes së ndalesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat personale për personelin ushtarak dhe civil, rezultoi se këto detyrime (ndalesa) në listëpagesa, janë llogaritur dhe mbajtur sipas kërkesave të legjislacionit përkatës, për pjesën që i takon të paguajë punëmarrësi.

Po kështu, detyrimi për sigurimin shoqëror suplementar, për ushtarakët, është mbajtur korrekt, në masën 5% të pagës referuese, bazuar në ligjin nr. 10142 datë 15.05.2009 “*Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakeve aktiv të FA të RSH.....*”.

Nga auditimi për rregullshmërinë, saktësinë e përlogaritjes dhe kryerjes së pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, për sa paguhet nga punëdhënësi, për të gjithë periudhën e audituar, rezultoi se pagesat janë kryer konform kërkesave ligjore.

Gjithashtu, xhirimi i ndalesave të mësipërme, pranë Drejtorisë së Tatimeve, Durrës janë kryer të plota. Nga auditimi dhe vlerësimi i praktikave, për respektimin dhe zbatimin e kërkesave dhe afateve të legjislacionit tatimor lidhur me deklaratimet, vihen re penalitete për deklarim të vonuar si:

Tatim në burim në korrik 2020 në vlerë 5,000 lekë, si dhe për kontributet e sigurimeve shoqërore korrik 2020 në vlerën 5,000 lekë,

Tatim në burim për periudhën Shtator 2023 në vlerë 5000 lekë.

Këto janë likuajduar me urdhër shpenzimi miratuar nga titullari.

II.3.7. Rregullshmëria e pagesave të shtesës për dëmshmëri shëndeti

Për periudhën objekt auditimi, QNOD Durrës nuk ka kryer pagesa të shtesës për dëmshmëri shëndeti për punonjësit mbështetës (*civilë*).

II.3.8. Trajtimi me pagesë papunësie e bashkëshorteve të ushtarakëve

Për periudhën objekt auditimi, pranë QNOD Durrës, nuk ka të trajtuar dhe nuk ka pagesa papunësie të kryera, për bashkëshortet e papuna të ushtarakëve që kanë shërbyer apo shërbejnë në QNOD-së Durrës.

II.3.9. Auditimi i respektimit të procedurave dhe dispozitave ligjore për trajtimin e personelit me ndihmë ekonomike të menjëhershme

Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare, (Rep.6012) Durrës, për periudhën objekt auditimi, ka kryer shpenzime nga fondet e miratuara, në artikullin 606 “*Transferta në Buxhetet familjare dhe Individët*”, sa mëposhtë;

- Për **vitin 2019**, janë miratuar (*plani fillestar me ndryshime*) 269,425 lekë dhe janë kryer pagesa në shumën 60,000 lekë.
- Për **vitin 2020**, janë miratuar (*plani fillestar me ndryshime*) 232,750 lekë dhe janë kryer pagesa në shumën 132,000 lekë.
- Për **vitin 2021**, janë miratuar (*plani fillestar me ndryshime*) 161,466 lekë dhe janë kryer pagesa në shumën 142,466 lekë.
- Për **vitin 2022**, janë miratuar (*plani fillestar me ndryshime*) 400,000 lekë dhe janë kryer pagesa në shumën 395,272 lekë.
- Për **vitin 2023**, janë miratuar (*plani fillestar me ndryshime*) 400,000 lekë dhe nuk janë kryer pagesa.

Nga auditimi i këtij zëri shpenzimesh konstatohet se, nga ky artikull (606), janë mbuluar shpenzimet për pagesat e shpërblimeve për dalje në pension të punonjësve dhe pagesa si ndihma të menjëhershme, për raste sëmundjesh apo raste vdekjesh të familjarëve të punonjësve, etj.

Nga auditimi i praktikave të shpenzimeve për pagesat e kryera, për raste të ndihmave të menjëhershme (*dalje në pension, sëmundje, vdekje, etj.*) konstatohet se këto pagesa janë kryer pas miratimit të fondeve përkatëse nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, bazuar edhe në urdhrin e zv/ministrit të Mbrojtjes, rast pas rasti.

Nga auditimi nuk u konstatuan pagesa më tepër.

II.4. Auditimi për respektimin e kërkesave të legjislacionit për vlerësimin e ruajtjes, administrimit dhe lëvizjes së aktiveve

Vlerësim i përgjithshëm

Për periudhën objekt auditimi, nga drejtimi i QNOD-së dhe strukturat e tjera të saj, janë programuar masat e nevojshme për të siguruar ruajtjen, mirëmbajtjen dhe administrimin e aktiveve.

Regjistrimi i aktiveve dhe mbajtja e kontabilitetit është kryer nëpërmjet programit Alpha-web.

Kontabilizimi i aktiveve është kryer mbi bazën e dokumenteve autorizues dhe vërtetues (*justifikues*) të lëvizjes së tyre. Kuadrimi ndërmjet përgjegjësit material dhe llogarisë nuk është kryer rregullisht.

Për mbështetjen me aktive (*materiale dhe shërbimeve*) në interes të mirëfunksionimit dhe realizimit të detyrave, QNOD-ja është bazuar kryesisht, në procedurat e blerjeve të aktiveve të realizuar nga vetë ajo, por edhe nga furnizimet e marra nga strukturat e Forcave të Armatosura (*Batalioni Furnizimit-Rep.4006*), për furnizimin, kryesisht, me karburant (*sipas normave të miratuara*), ndërlidhje, etj.

Kjo mbështetje është organizuar dhe ka funksionuar në përputhje me rregullat e vendosura, burimet materiale dhe njerëzore që ka patur në dispozicion.

Nga auditimi për respektimin e kërkesave të legjislacionit për vlerësimin e ruajtjes, administrimit dhe lëvizjes së aktiveve, konstatohet se janë respektuar kërkesat e legjislacionit, por, në shërbime të veçanta janë konstatuar shkelje dhe mangësi të cilat trajtohen në çështjet e më poshtme.

II.4.1. Vlerësimi i zbatimit të rregullave dhe procedurave të vendosura për ruajtjen, mbrojtjen e aktiveve nga humbjet, vjedhjet dhe keqpërdorimin e tyre

Nga auditimi i dokumentacionit për administrimin dhe ruajtjen e aktiveve nga humbjet, vjedhjet dhe keqpërdorimi i tyre, konstatohet se titullari i QNOD-së, bazuar në kërkesat e ligjit nr.25 datë 10.05.2018, "*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*", ligjit nr.10 296, datë 08.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*" i ndryshuar, udhëzimit të MF-së nr.30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*", rregulloret, etj., sipas periudhave, ka vendosur rregulla (*nëpërmjet urdhrave, udhëzimeve, tej.*) si dhe janë ndërmarrë veprimet për të siguruar ruajtjen e aktiveve që kanë patur në përdorim dhe administrim.

Këto rregulla kanë të bëjnë me caktimin e detyrave dhe përgjegjësi të punonjësve të caktuar në funksionet e ruajtjes dhe të menaxhimit të aktiveve, të ushtrimit të kontrollit për kryerjen në vazhdimësi të detyrave, në kryerjen e inventarizimit sipas rregullave të caktuara, në zbatimin e kërkesave ligjore për evidentimin, kontrollin e administrimin në tërësi si dhe të përdorimit të tyre.

II.4.2. Vlerësimi i procedurave të ndjekura për pritjen, kontrollin, regjistrimin, dokumentimin i lëvizjes së aktiveve, kuadrimi midis magazinës e llogarisë

Në kryerjen e angazhimit të auditimit, për të njohur më mirë punën e bërë në drejtim të regjistrimit të aktiveve, dokumentimin e lëvizjes së tyre, u shqyrtua dokumentacioni si me personelin e financës dhe me magazinierin, në përshtatje me ndarjen e detyrave që përgjegjësit material kanë në ruajtjen e administrimin e aktiveve.

Pranimi i aktiveve të furnizuara është bërë nga komisionet përkatëse, të cilët kanë dokumentuar me procesverbal pritjen, kontrollin dhe regjistrimin e aktiveve në respektim të kërkesave përcaktuara në udhëzimet përkatëse.

Po kështu, qarkullimi i aktiveve (*materiale dhe shërbimeve*) është bërë mbi bazën e dokumenteve autorizues (*urdhra veprimi, urdhra blerje, urdhra për krijimin e komisioneve, etj.*) dhe dokumenteve vërtetues bashkëlidhur (*flete hyrje, flete dalje, faturat, provesverbalet e pranimit e marrjes në dorëzim, etj.*), si dhe regjistrimet përkatëse janë kryer në programin Alpha-web.

Për aktivet afatgjatë, të vëna në përdorim ka regjistër ku evidentohet, vlera e aktivitetit, datën e vënies në përdorim, vlera e shpenzimeve të kryera për mirëmbajtjen e tyre, vlera e akumuluar e amortizimit, personi përgjegjës, sipas pikës 30 të udhëzimit të MF-së nr.30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”* i ndryshuar.

II.4.3. Vlerësimi i procesit të inventarizimit të aktiveve

Për vlerësimin e respektimit të kërkesave të legjislacionit dhe procedurave të ndjekura nga QNOD-ja (*Rep.6612*) Durrës, për inventarizimin e aktiveve në administrim dhe përdorim të saj, auditimi u bazua në kërkesat e ligjit nr. 25, datë 10.05.2018 *“Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”* i ndryshuar, ligjit nr. 10 296, datë 08.07.2010, *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”* i ndryshuar, udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”* i ndryshuar, urdhërit të Ministrit të Mbrojtjes nr. 933 datë 13.05.2016 *“Për kryerjen e inventarizimit të aktiveve dhe detyrimeve”* i ndryshuar me urdhërin nr. 1150 datë 29.06.2023, shkresat e Sekretarit të Përgjithshëm të MM-së *“Mbi kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimin e aktiveve në përdorim të njërive shpenzuese të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes”*, udhëzimit të Ministrit të Financave nr .3, datë 27.12.2011, i ndryshuar dhe urdhërat e titullarit të QNOD-së, në këtë drejtim.

Auditimi i procesit të inventarizimit u krye me zgjedhje dhe konkretisht, u audituan, praktikat e inventarizimit për vitin 2020 dhe 2022.

Nga auditimi i rregullshmërisë së dokumentacionit dhe respektimi i kërkesave të legjislacionit në procesin e inventarizimit të aktiveve, konstatohet se;

Për **vitin 2020** në zbatim të urdhërit të Ministrit të Mbrojtjes nr. 933 datë 13.05.2016 *“Për kryerjen e inventarizimit të aktiveve dhe detyrimeve”*, titullari i QNOD, ka nxjerë urdhër nr. 16 datë 15.06.2020 *“Për kryerjen e inventarizimit të aktiveve në QNOD për vitin 2020”*, së bashku me pasqyrën nr. 1, në të cilin janë përcaktuar një përgjegjës material dhe katër shërbime, përkatësisht: kazermim, karburant, teknike dhe ndërlidhje.

Në urdhërin e titullarit janë përcaktuar përbërja e komisionit, afati i kryerjes së inventarizimit, në përputhje me kërkesat e ligjit.

U shqyrtua dokumentacioni për artikujt e shërbimit kazermim, bashkëlidhur ishin:

- procesverbali nr. 31 datë 05.11.2020, i marrjes në dorëzim të aktiveve të furnizuara me objekt “Shpenzime/ material BCU”
- raport inventarizimi fizik të aktiveve i sigluar nga komisioni (3 vetë) i ngritur për këtë proces, ku pasqyrohet e gjithë procedura e ndjekur.
- deklaratë e përgjegjës material për kuadrin e llogarive në kontabilitet në programin Alpha-web, me librin e magazinës,
- procesverbal nr. 1 datë 21.10.2020 i mbajtur nga komisioni (3 vetë) dhe përgjegjësi material, ku pasqyrohen veprimet e kryera, të cilat rakordojnë me deklaratën e përgjegjës material dhe në përputhje me financën, si dhe me daljet e shkarkuara personelit në kartelat personale.
- procesverbal nr. 2 datë 05.11.2020, datë në të cilën është bërë hyrja në magazinë e “shpenzime/ material BCU”.
- Memo informuese e titullarit, në lidhje me përfundimin e procesit të inventarizimit nga komisioni.

Nga kontrolli i dokumentacionit të procesit të inventarizimit, u konstatua se ishin marrë të gjitha masat e planifikuara përpara fillimit të procesit, aktivet ishin të regjistruara saktë, në kartela të veçanta për çdo produkt, nuk rezultuan diferenca tepër apo mangët.

Të gjitha daljet ishin bërë në përputhje me urdhërin për marrjen në dorëzim nga komisioni.

Në përfundim të procesit të inventarizimit ishte hartuar dhe një raport mbi inventarin fizik të aktiveve për vitin 2020. Në krah të disa artikujve është shënuar “*seleksionim*” por nuk kishte informacion të detajuar për secilin artikull me relacion më vehte. Nga ana e grupit të auditimit u kërkua dokumentacioni dhe u shqyrtua procedura e inventarizimit për vitin 2023, e cila ka në përbërje dokumentacionin si më poshtë:

Urdhëri i Ministrit të Mbrojtjes nr.1150 datë 29.06.2023 “*Për kryerjen e inventarizimit dhe menaxhimit të aktiveve*”, si dhe shkresa e Sekretarit të Përgjithshëm nr 3670/2 datë 29.06.2023 “*Mbi kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimin e aktiveve në përdorim të njësive shpenzuese të sistemit të Ministrisë së Mbrojtjes*”.

Urdhër i titullarit nr. 50 datë 14.09.2023 “*Për ngritjen e komisionit të inventarizimit të aktiveve në QNOD për vitin 2023*”, Shkresë nr.592 datë 27.09.2023, dërguar Drejtorisë së Buxhetit dhe menaxhimit financiar “*Informacion mbi procesin e inventarizimit të aktiveve për vitin 2023*”. Praktika ka në përbërjen e saj dokumentat, si më poshtë:

- procesverbal nr. 1 datë 02.10.2023 për shërbimin magazinim (*inventari i imët, magazina 312, magazina e aktiveve afatgjata*).
- deklaratën në datë 02.10.2023 të personit i cili është përgjegjës material në këtë njësi.
- fletët e inventarizimit sipas kartelave të magazinës, dhe vërejtjet përkatëse, në fund të çdo fletë inventari firmosin: specialist finance, përgjegjës material dhe të gjithë pjesëtarët e komisionit.
- raporti “*Për inventarizimin fizik të aktiveve*” nr 640/1 datë 25.10.2023

- shkresë nr. 640 datë 25.10.2023 dërguar Drejtorisë së Buxhetit dhe menaxhimit financiar “*Informacion mbi përfundimin e procesit të inventarizimit të aktiveve për vitin 2023*”, së bashku me formularët bashkëlidhur (pasq.1, pasq. 3, pasq.4).

Nga kontrolli i dokumentacionit të procesit të inventarizimit, u konstatua se ishin marrë të gjitha masat e planifikuara përpara fillimit të procesit, aktivet ishin të regjistruara saktë, në kartela të veçanta për çdo produkt, nuk rezultuan diferenca tepër apo mangët.

Të gjitha daljet ishin bërë në përputhje me urdhërin për marrje në dorëzim nga komisioni.

Në përfundim të procesit të inventarizimit është hartuar dhe një raport mbi inventarin fizik të aktiveve për vitin 2023.

Opinion i grupit të auditimit: Rezultoi që artikujt janë të inventarizuar secili më vehte, si dhe ishin të regjistruar saktë, me procedurë të plotë e të rregullt, nuk kishte diferenca.

Për aktivet afatgjatë të vëna në përdorim, ka regjistër ku evidentohet, vlera e aktivitet, data e vënies në përdorim, vlera e shpenzimeve të kryera për mirëmbajtjen e tyre, vlera e akumuluar e amortizimit, personi përgjegjës, sipas pikës 30 të udhëzimit të MF-së nr.30, datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”.

II.4.4. Vlerësimi i administrimit të aktiveve dhe procesit të shkarkimit të tyre, sipas normave të miratuara

Gjatë auditimit u shqyrtua dhe dokumentacioni i historikut të regjistrimit të karburantit, artikullit gasoil D-1 (me kartë stiker).

U shqyrtua vlerësimi i procedurave, në zbatim të urdhërave mbi zbatimin e normave për furnizimin e shkarkimin e karburantit, kontabilizimin e lëvizjeve dhe ndryshimin e gjendjes në fund të periudhës.

U auditua dokumentacioni për periudhën 2019 - 2023, si hyrjet e karburantit dhe daljet e realizuara, si dhe procedura e tërheqjes nga ana e QNOD-së. Gjithashtu, nga grupi i auditimit u shqyrtuan dhe arsytet e lëvizjes sipas planeve dhe autorizimeve të miratuara nga drejtuesi i njësisë, shërbimet të rakorduara me temën e trajnimeve, vendin dhe kohën e qëndrimit të punonjësve, së bashku me vënien në dispozicion të mjetit të njësisë.

Kjo njësi ka patur një makinë të tipit mercedes benz me naftë me targë MM 422 MM nga periudha 2019-2022, furnizimet janë bërë me kartë sticker nga sistemi. Në dhjetor 2022, kjo njësi ka dorëzuar këtë makinë me procesverbal dhe ka marrë makinë të tipit ford me benzinë e pajisur me GPS.

Nga ana e grupit të auditimit u konstatuan disa problematika, si më poshtë:

Nga auditimi dokumentacionit, për periudhën 2019 - 2023, për respektimin e kërkesave ligjore, urdhërave dhe udhëzimeve të MM-së, për përdorimin e mjeteve dhe administrimin e shkarkimit e karburantit, rezultoi:

Për vitin 2019, përsa i takon furnizimeve me karburant referuar urdhërit MM nr.1689 datë 31.10.2019, komisionit të vlerësimit të normës së karburantit, si dhe tabelës nr. 3, për makinën e QNOD-së, autoveturë me gazoil, benz 200 me targë MM 422 MM, është përcaktuar normativa me 11 litra për 100 km. Kjo normë ka hyrë në fuqi në muajin nëntor 2019, ndërkohë që për periudhën janar– tetor ka qënë e përcaktuar norma 12 litra në 100 km, referuar urdhërit të MM nr 2089 datë 30.12.2015.

Nga auditimi i dokumentacionit të furnizimeve dhe shkarkimeve të karburantit, u shqyrtuan veprimevet e kryera sipas autorizimeve, referuar planit të miratuar për QNOD-në me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes nr. 377 datë 15.03.2019 *“Plan i detajuar i karburantit të FA për vitin 2019”*, për çdo vit objekt auditimit, nga rezultoi se janë administruar shkresat e furnizimit me karburant.

Nga ana e grupit të auditimit, është konstatuar se furnizimet me karburant kalohen direkt në furnizimin dhe administrohen në kartën elektronike sticker, nga drejtuesi i mjetit. Nga sektori i financës nuk ka rakordim të gjendjes së karburantit në serbatorin e makinës, me gjendjen në (kontabilitet) çdo fund viti, referuar ligjit nr.25, datë 10.05. 2018 *“Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”* ndryshuar, si dhe udhëzimit 30 të datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”*

Formatet e fletëve të udhëtimit të përdorura, duhet të plotësohen sipas standardit të ri të përcaktuar në urdhër nr. 339 datë 24.05.2004 *“Për një ndryshim në fletën e udhëtimit të automjeteve në përdorim të Forcave të Armatosura”*, Lidhja nr. 15.

Referuar observacionit të QNOD-së, janë sqaruar furnizimet dhe shkarkimet e karburantit si në vijim: gjendja e karburantit në 01.01.2019 ka qënë 133 litra, sipas kartelës së magazinës, si dhe evidencave të rakordimit (në shkresa zyrtare). Gjatë vitit, QNOD-ja ka tërhequr nga KM (Rep.4006), sipas fletë daljeve, sasinë prej 3,950 litra dhe mjeti ka kryer 32,492 km, pra ka konsumuar 3839 litra; për vitin 2020 është furnizuar me 4700 litra dhe është konsumuar 4777 litra; për vitin 2021 është furnizuar me 5000 litra dhe është konsumuar 4889 litra; për vitin 2022 është furnizuar 5000 dhe është konsumuar 5278 litra.

Në dhjetor të vitit 2022 , në zbatim të urdhërit SHSHPFA nr. 1241 datë 07.11.2022 *“Për kalim kapital automjetesh”*, është bërë dorëzimi i autoveturës me gazoil, benz 200 me targë MM 422 MM me procesverbal nr. 1 datë 07.12.2022 midis Rep.6012 (QNOD) dhe Rep.5001.

Rekomandim

Nga ana e QNOD duhet të plotësohen me përpikmëri kërkesat e udhëtimit të MF-së nr.30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”*, urdhër nr.339 datë 24.05.2004 *“Për një ndryshim në fletën e udhëtimit të automjeteve në përdorim të forcave të armatosura”*, si dhe të ligjit nr 25/ 2018 *“Për kontabilitetin dh pasqyrat financiare”*.

Përgjegjësi i Sektorit të financës, të ndjekë dhe të ushtrojë kontroll të vazhdueshëm, për kryerjen e rakordimeve vjetore, midis llogarisë, magazinës dhe drejtuesit të mjetit, si dhe me Batalionin e Furnizimit, për lëvizjet e karburantit duke regjistruar çdo veprim financiar në zbatim të ligjit nr 25/2018

.

II.4.5. Vlerësimi i administrimit të aktiveve dhe i procesit për nxjerrjen jashtë përdorimit të tyre

Gjatë angazhimit të auditimit në Qendrën Ndërinstitucionale Operacionale Detare (Rep. 6012), Durrës, për periudhën objekt auditimi, u audituan procedurat për vlerësimin, nxjerrjen jashtë përdorimit, shndërrimit dhe asgjësimit të aktiveve dhënë në administrim dhe përdorim, si dhe përpuethshmëria e këtyre procedurave me kërkesat e legjislacionit.

Titullari i QNOD-së, në respektim të kërkesave të udhëtimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”* i ndryshuar dhe udhëtimit të MM-

së nr. 3, datë 13.03.2011 *“Për afatet e përdorimit, kriteret, procedurat dhe kompetencat për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve në Forcat e Armatosura dhe rregullat për trajtimin e tyre pas heqjes nga armatimi dhe përdorimi”*, për realizimin e këtij procesi, ka nxjerrë urdhrat përkatës për krijimin e komisioneve të vlerësimit për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve dhe atë të shndërrimit e asgjësimit të aktiveve.

Për vitin 2020: QNOD-ja, ka vlerësuar, nxjerrë jashtë përdorimit, asgjësuar aktive materiale të dhëna në administrim dhe përdorim, sipas formatit SU10 në shërbime *“kazermim dhe teknike”* në vlerën 7,496,761 lekë.

Referuar kundërshtimeve (*observacionit*) të ardhura nga QNOD, të gjitha materialet e vlerësuara e të asgjësuara sipas fletë daljes nr. 16.12.03.2020; procesverbalit nr. 46/6 datë 11.03.2020 SU11, pavarësisht kujt shërbimi i përkasin, janë kompetencë e titullarit të QNOD-së dhe janë proceduar sipas udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”* dhe udhëzimit të MM nr 3 datë 13.03.2012 *“Për afatet e përdorimit, kriteret, procedurat dhe kompetencat për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve në FA dhe rregullat për trajtimin e tyre pas heqjes nga armatimi dhe përdorimi”*.

Për vitin 2022: QNOD-ja, ka vlerësuar, nxjerrë jashtë përdorimit, asgjësuar aktive materiale të dhëna në administrim dhe përdorim, në shërbim *“kazermim dhe teknike”* në vlerën 3,508,252 lekë, ndërsa në shërbimin *“ndërlidhje”* në vlerë 5,045,588 lekë.

Nga vlerësimi i procedurave për respektimin e kërkesave të përcaktuara nga legjislacioni që rregullon këtë veprimtari, në shërbimet e mësipërme, rezultoi se aktivet e vlerësuara, të nxjerra jashtë përdorimit dhe të shkarkuara nga llogaria, janë aktive të cilat kanë plotësuar afatin e përdorimit, janë të dëmtuara (*thyerë, djegur*), kanë dalë jashtë funksionit apo që nuk gjejnë më përdorim.

Nga auditimi vlerësohet se, janë respektuar kërkesat e legjislacionit në këtë fushë, por u konstatua se ; Në procesin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve, në zbatim të udhëzimit të MF-së nr.30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”*, si dhe udhëzimit të Ministrit të Mbrojtjes nr.3, datë 13.03.2012 *“Për afatet e përdorimit, kriteret, procedurat dhe kompetencat për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve në Forcat e Armatosura dhe rregullat për trajtimin e tyre pas heqjes nga armatimi dhe përdorimi”*, si dhe referuar pikës 12.6 të udhëzimit 3/2012 të MM, *“Për afatet e përdorimit, kriteret, procedurat dhe kompetencat për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të Forcat e Armatosura dhe rregullat për trajtimin e tyre pas heqjes nga përdorimi”*, titullari i QNOD-së me urdhër nr. 14 datë 07.03.2022, ka ngritur komision për vlerësimin e aktiveve. Ky komision, pasi ka vlerësuar pajisjet, ka hartuar procesverbalin nr. 200/2 dhe nr. 200/3 datë 16.03.2022 *“Për vlerësimin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të vitit 2022”*, sipas formatit përkatës SU10, duke përcaktuar dhe shkaqet e nxjerrjes jashtë përdorimit, në bazë të kriterëve, amortizimit, gjendjes teknike të tyre. Komisioni ka përdorur procesverbal SU3 për çdo artikull, si dhe pasqyrat përmbledhëse të pajisjeve të cilat përbëhen nga 18 artikuj kompjuter standard Fujitsu.

Referuar shkesës nr. 511 datë 15.08.2024 *“Dërgim i materialeve me kundërshtimet dhe sugjerimet përkatëse në lidhje me projektraportin e auditimit të brendshëm”*, për këtë pikë na është vënë në

dispozicion dhe urdhëri i SHSHPFA nr. 671 datë 15.07.2022, ku në pikën 3 të tij është sqaruar që QNOD përgjigjet për zbatimin e urdhërit.

Për pajisjet e tjera (*jo kompjutera*), janë ngritur komisionet për nxjerrjen jashtë përdorimit, por nuk ka informacion të detajuar si, procesverbal dëmtimi, relacion të shndërrimit, fotografi, etj.

Rekomandim

Spektori i financës dhe komisionet përkatëse, për çdo rast të praktikave të shndërrimit dhe asgjësimit të aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit, që digjen apo groposen, t'u bashkëlidhë dokumentacionin justifikues, relacionin përkatës të shndërrimit, fotografi, etj, në zbatim të udhëzimit 3/2012 të MM, "*Për afatet e përdorimit, kriteret, procedurat dhe kompetencat për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të Forcat e Armatosura dhe rregullat për trajtimin e tyre pas heqjes nga përdorimi*".

II.4.6. Vlerësimi i zbatimit të afateve dhe plotësimi i dokumentacionit për qarkullimin pa pagesë të aktiveve materiale

Plotësimi i nevojave të Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare (*Rep. 6012*), Durrës me aktive materiale dhe shërbime, është realizuar nëpërmjet procedurave të blerjeve nga vetë QNOD-ja, si dhe nga struktura të tjera të Forcave të Armatosura dhe Batalioni i Furnizimit (*Rep.4006*), kryesisht për furnizimin me karburant.

Për vlerësimin e respektimit të kërkesave të përcaktuara në VKM nr.45, datë 14.02.1994, "*Për qarkullimin pa pagesë të vlerave materiale*", udhëzimin e MF-së nr.30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*" dhe udhëzimit të MM nr.281, datë 31.07.2001 "*Për qarkullimin pa pagesë të vlerave materiale brenda sistemit të FA-së*", u auditua rregullshmëria e dokumentacionit për qarkullimin (*lëvizjen*) e aktiveve materiale, brenda sistemit të Forcave të Armatosura, si fletë-hyrje, fletë-dalje, konformarrje, urdhër dorëzimi, autorizimet për tërheqje malli dhe procesverbale për marrjen në dorëzim të aktiveve.

Nga auditimi në QNOD, rezulton se qarkullimi (*lëvizja*) e aktiveve materiale pa pagesë, është bërë konform kërkesave të akteve të mësipërme, pasi të gjitha fletë daljet për furnizimin nga strukturat e tjera të FA-së, rezultuan të kompletuara me konformarrje, kundrejt shkresës përcjellëse dhe me dokumentacion përkatës (*fletë-hyrje, fletë-dalje*).

Fletë-daljet dhe fletë-hyrjet e aktiveve, rezultuan me përputhshmëri në sasia dhe vlerë, si dhe brenda afateve të përcaktuara.

III. AUDITIM I RREGULLSHMËRISË FINANCIARE

Të përgjithshme

Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare (*Rep. 6012*), Durrës, përdorimin e aktiveve financiare të miratuara e ka kryer nëpërmjet bankës.

Dokumentacioni bazë dhe justifikues i pagesave të kryera nëpërmjet bankës, është regjistruar konform rregullave të vendosura dhe standardeve të kontabilitetit.

Pagesat për paga, janë kryer mbi bazën e listëpagesës së përgatitur nga sektori i financës dhe sektori i personelit, të cilat janë miratuar nga titullari i QNOD-së, përgatitja e tyre është bazuar në listë prezencën mujore në punë.

Pagesat e tjera, për blerjen e aktiveve (*mallra, shërbime, etj.*) janë bazuar në dokumentacionin autorizues dhe vërtetues (*justifikues*), në raport këto me fondet e miratuara dhe të detajuara, sipas periudhave.

Në ditarin e bankës, i cili mbahet në programin elektronik, veprimet e pagesave të kryera, janë regjistruar në kredi të llog. 512 – banka dhe në debi të llogarive të thesarit, llog. 600, 601, 602, 606 dhe llog. 231 e nënllogaritë e tyre, por njëkohësisht edhe sipas llogarive kontabël si nga 400 – 436, etj. QNOD-ja, për periudhën objekt auditimi, ka kryer veprimeve me bankat dhe konkretisht, Raiffeisen Bank, Banka Kombëtare Tregtare (BKT), Credins Bank .

III.1. Auditimi i rregullshmërisë së pagesave dhe arkëtimeve për veprimet e kryera nga arka

Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare (*Rep. 6012*), Durrës, për periudhën objekt auditimi, nuk ka kryer veprime dhe pagesa nëpërmjet arkës.

III.2. Vlerësimi i procedurave dhe rregullave në dokumentimin e vlerave monetare, zbatimi i ligjshmërisë për veprimet e kryera nëpërmjet bankës

Auditimi i aktivitetit të bankës ka si objektiv, kontrollin e veprimeve të kryera me bankë të nënshkruara nga personat e autorizuar, mbështetur në dokumentacionin ligjor, besueshmërinë e pagesave të kryera, për periudhën objekt auditimi, rakordimin e urdhër shpenzimeve, vlerave të faturave, me procesverbalet e pritjes dhe marrjes në dorëzim të aktiveve, hyrjet në depo, vlerësimin dhe funksionimin e komisioneve të blerjeve me vlera të vogla, të komisionit të pritjes, kontrollit dhe marrjes në dorëzim të mallrave dhe shërbimeve, respektimin e çmimeve për mallrat dhe shërbimet e blera, si dhe zbatimi i akteve të tjera ligjore dhe nënligjore.

Veprimtaria e bankës u auditua bazuar në dispozitat ligjore si, kërkesat e ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “*Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH*” i ndryshuar, ligjit nr. 10 296, datë 8.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*” ndryshuar, ligjit nr.25/2018 “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*” i ndryshuar, të udhëzimit të MF-së nr.30 datë 27.12.2011 “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar, urdhërat dhe udhëzimet e MM, Sekretarit të Përgjithshëm të MM dhe urdhrat e titullarit të QNOD-së.

Administrimi dhe qarkullimi i fondeve të miratuara nga MM-ja, për aktivitetin e QNOD-së është realizur nëpërmjet veprimeve të kryera nga bankat dhe konkretisht, Raiffeisen Bank, Banka Kombëtare Tregtare (BKT), Credins Bank.

Sipas dokumentacionit për aktivitetin e kryer nëpërmjet bankës, konstatohet se për periudhën objekt auditimi, sektori i financës së QNOD-së, ka kryer shpenzime dhe pagesa, janë derdhur kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shendetësore për pagat e punonjësve, blerjet me vlera të vogla, pagesa të personelit për shpenzime udhëtimi/dieta, jashtë qendrës punës, brenda vendit, pagesa për të tretët (telefon), pagesa për ndihma ekonomike të menjëhershme për raste fatkeqësie apo sëmundje, janë likuiduar kompensim ushqimor sipas listave të përsoneve përfitues.

III.3. Auditimi i respektimit të procedurave dhe dispozitave ligjore, për blerjet me vlera të vogla dhe kryerjen e pagesave

Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare (Rep. 6012), Durrës, në cilësinë e autoritetit kontraktor, për periudhën 2019 – 2023, bazuar në kërkesat dhe nevojat për mallra dhe shërbime, ka planifikuar dhe kërkuar në MM miratimin e fondeve si dhe është bërë çelja e tyre për çdo vit në nivel artikulli.

Për çdo viti buxhetor, nga institucioni është hartuar regjistri i parashikimit të prokurimit publik, i cili është dërguar për miratim në MM, në përputhje me kërkesat e ligjit, si dhe regjistrat e realizimit për periudha një vjeçare. Nga titullari i QNOD-së, për çdo vit, është ngritur komisioni i blerjeve me vlera të vogla dhe komisioni i pritjes dhe marrjes në dorëzim të aktiveve.

Referuar regjistrat të realizimit të prokurimit publik, për periudhën e audituar, janë zhvilluar prokurime me vlerë të vogël nga 100,000 lekë deri në 1,000,000 lekë.

Nga auditimi për respektimin e kërkesave të legjislacionit për procedurat prokurimit *“Blerje me vlerë të vogël”* të realizuara nga vetë QNOD-ja, si autoritet kontraktor, u bë vlerësimi i procedurave të prokurimit blerje me vlerë të vogël, për përllogaritjen e fondit limit, përgatitjen e dokumentacionit përkatës, specifikimet teknike, zhvillimin e procedurave dhe përputhshmërinë e veprimeve me legjislacionin dhe rregullat që menaxhojnë fushën e prokurimeve publike.

Auditi konstatoi se regjistri i parashikimit dhe ai i realizimit të procedurave të prokurimit publik është plotësuar me *“vlera pa tvsh”*, ndërkohë që në udhëzimin përkatës të APP-së me nr.4, datë 18.06.2021 kërkohej të plotësohet me vlerën e kontratës së nënshkruar.

Në observacionin e dërguar nga QNOD jepet sqarimi se, lidhur me këtë çështje, nuk ka patur efekte financiare.

Rekomandim

Regjistri i parashikimit dhe ai i realizimit të procedurave të prokurimit publik të plotësohet me vlerën e kontratës së nënshkruar, ashtu siç e parashikon udhëzimi përkatës i APP-së me nr.4, datë 18.06.2021.

III.4. Auditimi i respektimit të procedurave dhe dispozitave ligjore për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës dhe kryerja e pagesave

Dërgimi me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit, i personelit të Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare (Rep. 6012), Durrës, për periudhën e audituar, është bërë kundrejt autorizimeve *“Për dërgim me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”*, të miratuara nga titullari i QNOD-së, rast pas rasti.

Për periudhën objekt auditimi, janë programuar, miratuar (*buxheti me ndryshimet*) dhe kryer shpenzime për shërbime udhëtimi dhe dieta, brenda vendit, sa mëposhtë;

Nr	Vitet	Shpenzime udhëtimi	Realizimi (shpenzime faktike) vlera ne lekë
1	2019	Udhëtime të brendshme	200,510
2	2020	Udhëtime të brendshme	115,500
3	2021	Udhëtime të brendshme	199,500
4	2022	Udhëtime të brendshme	259,000
5	2023	Udhëtime të brendshme	113,000

Nga auditimi dhe vlerësimi i praktikave për respektimin dhe zbatimin e kërkesave të legjislacionit për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit, rezultoi se janë respektuar kërkesat e përcaktuara në VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “*Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit*” i ndryshuar.

III.5. Zbatimi kontratave të lidhura nga QNOD-ja dhe marrja në dorëzim e aktiveve të furnizuara sipas llojit të tyre. Vlerësimi i procedurave dhe të ndjekura për pritjen, kolaudimin dhe kontrollin e aktiveve të blera gjatë periudhës që auditohet

Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare (Rep. 6012), Durrës, për periudhën objekt auditimi, nuk ka lidhur kontrata për marrje në dorëzim të aktiveve të furnizuara, sipas llojit të tyre.

Ndërsa vlerësimi i procedurave të ndjekura për pritjen, kolaudimin dhe kontrollin e aktiveve të blera nga QNOD-ja, gjatë periudhës që auditohet, është trajtuar në pikën III. 3, mësipër, ku trajtohen procedurat e blerjeve me vlera të vogla.

III.6. Vlerësimi i natyrës së detyrimeve debitore dhe respektimi i kërkesave për arkëtimin e tyre

Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare (Rep. 6012), Durrës, për periudhën objekt auditimi, nuk ka krijuar dhe nuk ka detyrime debitorë.

III.7. Administrimi i të ardhurave të krijuara nga dhënia me qira e objekteve, punimeve dhe shërbimeve me të tretët dhe kontabilizimi i tyre

Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare (Rep. 6012), Durrës, për periudhën objekt auditimi, nuk ka dhënë objekte me qira.

IV. TË TJERA

Respektimi i kërkesave të legjislacionit për ndihma, donacione nga të huaj

Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare (Rep. 6012), Durrës, për periudhën 2019– 2023, ka administruar ndihma të dhuruara nga qeveritë e huaja (në aktive materiale) për QNOD.

Nga British Embassy and Border and Force, kanë ardhur disa donacione të huaja, kryesisht pajisje elektronike, në vite të ndryshme brenda periudhës objekt auditimi.

Nga ana e grupit të auditimit, u shqyrtua rasti i aktiveve të dhuruara nga Border Force (British Embassy), pasi u shqyrtua dokumentacioni, rezultoi:

Komisioni i ngritur, për marrjen në dorëzim të aktiveve, me urdhër nr.4 të datës 16.01.2020 të Drejtorit Administrativ, ka hartuar procesverbalin nr.25 datë 25.09.2020 i cili është bërë bazuar në dokumentin e dhurimit nr. 10 të datës 25.09.2020, është bërë fletë hyrje nr.24 datë 25.09.2020 me vlerë sipas artikullit dhe janë bërë hyrje në magazinë.

Të gjitha pajisjet janë regjistruar në kartela të veçanta për çdo artikull:

1. Kompjuter HP (PC 1394 & Screen 0555), 2 copë, në vlerën 116,980 lekë/copa
2. Kompjuter HP (1499), 3 copë, në vlerën 54,990 lekë/copa
3. Lap Top (DELL 1364), 1 copë, në vlerën 139,990 lekë/copa
4. TV Samsung (LED UE 65RU3804), 2 copë, në vlerën 94,990 lekë/copa.

Nga auditimi i procesit të administrimit të donacioneve, nuk u konstatuan shkelje të udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”*, i ndryshuar.

Referuar edhe procesit të inventarizimit, këto mallra janë pasqyruar saktë në fletët e inventarizimit.

Gjithashtu, u shqyrtua dhe një donacion tjetër nga po ky subjekt, protokolluar në QNOD me nr. 545 datë 30.08.2023, ku janë marrë në dorëzim aktive me procesverbal nr. 17 datë 30.08.2023 *“Për marrje në dorëzim të aktiveve të dorëzuara”*, si dhe fletë hyrje në magazinë nr. 15 datë 30.08.2023.

Me këtë praktikë, janë dhuruar tre kondicioner. Këto mallra janë hedhur dhe janë mbajtur saktë dhe në kontabilitet në llogarinë përkatëse, si dhe janë regjistruar saktë në fletën e inventarizimit të aktiveve afatgjatë për vitin 2023 të miratuar nga komisioni.

Nga UNDP është dhuruar (tablet), bazuar në dokumentin e ardhur dhe të protokolluar me nr. 37 datë 16.01.2020 është hartuar procesverbali nr. 1 datë 16.01.2020 nga komisioni i ngritur, për marrjen në dorëzim të aktiveve si dhe është bërë hyrje në magazinë dhe është regjistruar në kartelën përkatëse.

Donacionet rezultojnë të magazinuara saktë të kontabilizuara në kartela më vehte.

VI.1. Auditimi i pasqyrave financiare

Objektivi i auditimit ka qenë, vlerësimi dhe organizimi i mbajtjes së kontabilitetit, ndarja e detyrave, rregullshmëria e kryerjes së veprimeve ekonomike sipas parimeve kontabël dhe rregullave në fuqi, rakordimi i të dhënave me ditarët dhe llogarit analitike, reflektimin në mënyrë besnike të gjendjeve të njësisë në bilanc dhe pasqyrat financiare.

Për hartimin e pasqyrave financiare të periudhës së audituar 2019 - 2023, janë mbajtur parasysh kërkesat e përcaktuara në ligjit nr. 25 datë 10.05.2018 *“Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”*, dhe në udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 5, datë 22.02.2022 *“Mbi ndryshimin e udhëzimit nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme””*.

Gjendjet e llogarive në fund të periudhave janë rezultat i shtesave dhe pakësimeve (*debi dhe kredi*), duke zbatuar standartet e kontabilitetit në mbajtjen e llogarive.

Pasqyrat financiare, për periudhën e audituar, janë dërguar brenda afateve të caktuara në degën e thesarit dhe MM. Janë kontrolluar llogaritë materiale dhe janë kryer verifikimet me kartelën e llogarive dhe secilën llogari të pasqyruar në pasqyrat financiare.

Duke krahasuar rubrikat, postet, dhe llogaritë kontabile, konstatohet si më poshtë vijon:

Gjendja e llogarive të vitit 2019, 2020, 2021, 2022, 2023 është e barabartë me gjendjen e pasqyruar në bilancin e mbyllur të vitit paraardhës.

Gjatë auditimit të pasqyrave financiare të viteve 2019- 2023, evidentohet se:

Janë kontrolluar llogaritë materiale dhe janë kryer verifikimet me kartelën e llogarive, dhe secilën llogari të pasqyruar në pasqyrat financiare.

Shuma totale e llog. të sipërcituara në fund të vitit ushtrimor, rezulton e njëjtë sipas kartelës së llogarive dhe formatit 7/a të pasqyrave financiare:

Sa më sipër evidentojmë se nuk vërehen pasaktësi në shumat e pasqyruara sipas kartelës së llogarive dhe formatit 7/a të pasqyrave financiare: (në të njëjtën masë janë shtuar dhe pakësuar).

Pasqyra Aneksë Statistike formati nr.7/b dhe formati nr. 1, pasqyra e pozicionit financiar në llogari 210-218 janë të njëjta për vitin 2019 dhe vitin 2023.

Konkluzion

Nga auditimi i pasqyrave financiare vjetore është konstatuar se:

Pasqyrat financiare, për vitet ushtrimore 2019, 2020, 2021, 2022, 2023, nuk rezultojnë me mangësi në respektimin e rregullave dhe standarteve kontabël.

QNOD, për periudhën objekt auditimi, ka kryer veprime financiare vetëm nëpërmjet bankës dhe janë regjistruar konform rregullave dhe standardeve të kontabilitetit. Veprime me arkë nuk ka.

Në ditarin e bankës i cili mbahet në programin elektronik Alpha-web, veprimet e pagesave të kryera, janë regjistruar në kredi të llog. 512 – banka dhe në debi të llogarive të thesarit, llog. 600, 601, 602, 606, si dhe nga 400 – 436, sipas llogarive kontabël.

Ky raport auditimi, mbahet në 3 (tre) kopje, të njëjta, nga të cilat 1 (një) kopje i dërgohet Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare (Rep. 6012), Durrës, 1 (një) kopje në Sekretarinë e Ministrisë së Mbrojtjes dhe 1 (një) kopje për Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm.

Grupi i punës:

Znj. Irida **BUSHATI**, Përgjegjëse grupi

Znj. Arsela **MARKU**, audituese